



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNË

Mbështetur në nenin 9, të Ligjit Nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr. 34/2016, datë 28.04.2016, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Entit Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, ERRU shpall konkurrim për vend të lirë pune, në pozicionin:

➤ ***Sekretare e Komisionit Kombëtar Rregullator dhe Kryetarit të ERRU***

Kërkesa të përgjithshme për kandidatët

- Të jetë shtetas shqiptar;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kundravajtjeje penale me dashje;
- të mos ketë lidhje familjare me anëtarët e KKRR, apo me punonjës të tjerë të administratës së ERRU, me të cilët ka lidhje hierarkie;
- të ketë kryer studimet e larta të nivelit DND;
- të ketë njohuri shumë të mira të procedurave administrative;
- të ketë përvojë pune jo më pak se 3 vjet;
- të ketë aftësi të mira komunikimi e prezantimi si dhe të punës në grup;
- të ketë njohuri të gjuhës angleze të vërtetuara.

Kandidatët duhet të paraqesin brenda datës 30.09.2019, ora 16.30 në Zyrën e protokollit të ERRU, në adresën Blv. "Bajram Curri", Rr. "Viktor Eftimiu", ish godina e KESH, kati IV Tiranë, këto dokumenta:

- Kërkesë me shkrim;
- Jetëshkrimin profesional;
- Fotokopje e noterizuar e diplomës;
- Fotokopje e noterizuar e listës së notave;
- Fotokopje e noterizuar e librezës së punës ;
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Formular i nënshkruar i Vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim i njohjes së gjuhës angleze;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;